

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA E KOSOVËS GOVERNMENT QEVERIA	
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE AGENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Niveli Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i Fazeve Br. Stranica No. Pages	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data : Datum : Date Pristupitë / a
A.Q.P 7	15/13 05.02.2013



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance**  
**AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**  
**CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY**

**Plani i Punës së AQP-së për vitin 2013**

**Hyrje**

Para miratimit të Ligjit të ri për Prokurimin Publik në tetor 2011, AQP-ja ka qenë e pavarur dhe është quajtur Agjencia për Prokurimin Publik (APP). Edhe pse mandati i APP-së nuk ka qenë aq i ndryshëm, në praktikë ajo ka nxjerrë vendime për procedurat e prokurimit publik për të gjitha A.K. në sistemin e prokurimit publik. Si rezultat i heqjes së këtij funksioni të kontrollit që e ka pasur para kësaj ngjarjeje, AQP-ja është në proces të përshtatjes në rolin e saj të drejtpërdrejtë të blerësit kryesor. Ky rol i ofron AQP-së dhe autoriteteve kontraktuese, si edhe operatorëve ekonomikë, mundësi dhe sfida të reja.

Në pajtim me Pjesën VII, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L042), Agjencia Qendrore e Prokurimit, është themeluar në kuadër të Ministrinë së Financave.

Referimet ndaj "Ligjit" janë referime ndaj Ligjit Nr. 04/L-042, mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

## Misioni

Agjencia Qendrore e Prokurimit , është një agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

AQP, është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të Ministrisë së Financave dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative.

Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr.04/L-042, neni 95 Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik mandatohet si organ qendror për prokurime te centralizuara qoftë në nivel qendror ( Ministri) apo lokal (Komuna).

Qëllimet kryesore të AQP-së janë në përputhje me misionin dhe funksionet e saj si Agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave dhe në kryerjen e detyrave të besuara dhe të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042 dhe atë me sa vijon:

- Implementimi i Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës (ndryshimeve ) do te mundësojë vendosjen e një sistemi te ri te prokurimit i cili është ne pajtim te plote me direktivat evropiane.
- Përgatitjen e analizave dhe raporteve drejtuar Ministrisë së Financave për dhënien e informacioneve dhe rekomandimeve specifike për sistemin e prokurimit ( përparësitë dhe te metat) dhe përmirësimin e mëtutjeshëm te sistemit te prokurimit publik.

### **Aktivitetet e Agjencisë Qendrore të Prokurimit në fushën e Prokurimit.**

Agjencia Qendrore e Prokurimit aktualisht është e koncentruar në kryerjen e detyrave të përcaktuara me Nr. 04/L-042 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë dhe atë me sa vijon:

Shqyrtimin e kërkesave nga Autoritetet Kontraktuese - prokurimeve të ndryshme (të cilat përfshijnë prokurime në vlera të mëdha dhe të natyrave komplekse), respektivisht shqyrtimin e kërkesave nga Autoritetet Kontraktuese për zbatimin e procedurave alternative në raste kur specifikat e prokurimeve të ndryshme e kërkojnë një gjë të tillë.

Në vazhdim po ju paraqesim përgjegjësit ligjore të AQP-së në fushën e Prokurimit sipas LPP –ës nr. 04/L-042

- Pranimi në menyrë elektrionike të planifikimeve të prokurimit nga autoritetet kontraktuese në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.
- Dorëzimi i listës për prokurime qendrore në MF siç parashihet në LPP
- Procedura të negociuara në emër të Agjencisë Qendrore të Prokurimit
- Revokime të nenit në emër të Agjencisë Qendrore të Prokurimit
- Pranimi i deklaratave për disponueshmeri të mjeteve siç parashihet me LPP ,nga AK të cilat nuk i kanë parapa në planifikimet e tyre përfundimtare .
- Udhëheqja me procedura të centralizuara të prokurimit për të gjitha Autoritetet Kontraktuese
  
- Shqyrtimi i kërkesave për tender jo normalisht të ulet në emër të Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
- Asistim me anëtar të komisionit vlerësues sipas kërkesave të Autoriteteve Kontraktuese.
- Asistim me procedura të prokurimit në rastet kur krijohen institucione të reja dhe udhëheqja e procedurave të prokurimit në emër të tyre.
- Udhëheqja me projektet e bankës botërore,dhe projekte speciale si donacione nga Qeveritë e jashtme etj .
- Përgatitja e listës përfundimtare për mallrat e përdorimit të përbashkëta për MF
- Zhvillimi i aktivitetit të Prokurimit për procedurat e centralizuara në emër të Autoriteteve Qendrore dhe Lokale,kuptohet pas miratimit të MF-Qeverisë.
- Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit në emër të autoriteteve tjera kontraktueses,kuptohet pas autorizimit të Ministrit të MF që autorizon AQP-ën si AK ,për zhvillimin e atij aktiviteti të prokurimit.
- Ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e prokurimit,natyrisht me kërkesën e AK.

- Gjatë vitit 2013 pritet të kryhet Ri-Dizajnimi i faqes së AQP-ës.

Sistemi i ri i prokurimit, që është edhe objektiva / politika kryesore e Agjencisë Qendrore të Prokurimit, të ndihmojë në mase të madhe Institucionet Kosovare për krijimin ose zhvillimin e infrastrukturës ekonomike dhe financiare të Kosovës duke shfrytëzuar në mënyrë me efikase paratë publike dhe kreditë financiare të huazuara nga organizmat financiarë ndërkombëtare, si donacionet nga qeveritë e vendeve tjera që investojnë në Kosovë si dhe projektet nga Banka Botërore.

### **Objektivat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit**

Objektivat ose politikat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP) në zhvillimin e mëtutjeshëm janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe të përmbledhura në disa pika në vijim :

Strukturimi organizativ i AQP-së në pajtim të plotë me ndryshimet dhe amandamentimet e LPP-se me qëllim të funksionalizimit dhe ngritjes së efektivitetit për përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga LPP-ja pas ndryshimeve. Agjencia Qendrore e Prokurimit parasheh të themelohen 4 divizionet e AQP-se në baze të ligjit të ri të prokurimit publik të Kosovës.

Në bazë të ligjit nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik neni 94 themelohet Agjencia Qendrore e Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Financave, AQP do të zbatoj dhe të kryej funksione dhe përgjegjësi të specifikuara në këtë ligj. Për punën dhe veprimtarinë e saj AQP nëpërmjet raporteve vjetore është e obliguar të informon Ministrinë e Financave lidhur me zhvillimet në sistemin e Prokurimit Publik dhe të zbatimit të Ligjit. Në këtë drejtim AQP do të përpiqet të ofroj Ministrisë së Financave informacione të nevojshëm për maksimalizimin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore posaçërisht për aplikimin e kontratave kornizë (afatgjata dhe të centralizuara).

Në themelimin e sektorëve profesionale për zbatimin e projekteve speciale sidomos ato të Bankës Botërore për të cilat Ministria e Financave do të besoj AQP-se si dhe sektorëve

tjera profesionale varësisht nga përgjegjësit dhe kërkesat e LPP-se te cilat i adresohen AQP-së.

AQP, ne pajtime me autorizimet qe rrjedhin nga LPP Ne bashkëpunim me firmën konsulentë të angazhuar për të asistuar KRPP-në, OSHP, KIPA-në dhe AQP-në me qellim implementimin e ligjit janë te parapara trajnime speciale për parimet e prokurimit publik dhe etikes, menaxhimit te materialeve dhe planifikimit, parimet e ligjit te kontratave, përgatitja dhe lansimi i tenderëve, teknikat e negocimit, përgatitja dhe menaxhimi i projekteve kapitale, projektet për pune dhe monitorimi, etj në te cilat AQP-do te jete e kyçur ne mënyrë aktive, në komitetin drejtues.

Në funksion të transparencës, efikasitetit , kursimit të mjeteve buxhetore , bashkopunimit më efikas me autoritetet kontraktuese, Agjencia Qendrore e Prokurimit për të ardhmen , do ti kushtojë vëmendje të posaçme nder të tjera edhe këtyre objektiveve :

1. Për vitin 2013 , sfida e veçantë për AQP-në do të jetë përgatitja e listës së artikujve të përdorimit të përbashket dhe dorëzimi i sajë në një kohë sa më të shpejtë në Ministrinë e Financave.
2. Agjencia Qendrore e Prokurimit vëmendje të veçantë do ti kushtojë ngritjes së kapaciteteve profesionale të kuadrove , me qellim të ngritjës së besueshmerisë së autoriteteve kontraktuese dhe palëve me interes, në veprimtarinë e institucionit të sajë .
3. Krijimin e kushteve të nevojshme për punë sa më të suseshme , duke u orientuar në rritjen e stafit profesional në fushen e prokurimit publik .
4. Angazhimin e ekspertit nderkombetar dhe atij nacional në fushen e prokurimit publik , për zhvillimin e procedurave të centralizuara do të paraqesin një ndihmesë të veçantë për zyrtaret e prokurimit në veçanti dhe AQP-në si institucion që është mandatar si organ qendror për blerje të centralizuara me Ligjin e ri të Prokurimit Publik të Kosovës Nr.04/L-042.

## Politikat kryesore

Politikat kryesore te AQP-së janë të orientuara ne zbatimin sa me te mire dhe te drejtë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë NR/04/L-042 si dhe te ligjeve te buxhetit qe janë fuqi, dhe atë me sa vijon:

1. Krijimi i kushteve për implementimin e ligjit dhe zbatimi i tij në praktikë
2. Zbatimi i ligjit rreth shfrytëzimit te buxhetit ne mënyre sa më racionale dhe transparente në harmoni me ligjet e buxhetit ne fuqi.
3. Ngritjen e burimeve njerëzore dhe profesionale në AQP
4. Përgatitja e plan kesh-it dhe dorëzimi i tij ne kohë te caktuar ne MF
5. KASH-i
6. Respektimi e afateve kohore rreth qarkoreve buxhetore
7. Dorëzimi i raporteve te buxhetit ne përfundim te vitit fiskal.
8. Përgatitja e pasqyrave financiare sa me te sakta dhe dorëzimi i tyre brenda afatit kohor te parapare me udhëzimet administrative në fuqi

### Trendët historike të financimit

	2011	2012	2013
Totali	161.617.00	161.617.00	161.617.00
Paga dhe shtesa	98.017.00	98.017.00	98.017.00
Mallra dhe shërbime	60.000.00	60.000.00	60.000.00
Shpenzime komunale	3.600.00	3.600.00	3.600.00
Numri i Stafit	15	15	15

## Vlerësimet e KASH-it

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
<i>Totali</i>	161.617.00	392.034.00	332.034.00	332.034.00
Paga dhe shtesa	98.017.00	196.034.00	196.034.00	196.034.00
Mallra dhe shërbime	60.000.00	130.000.00	130.000.00	130.000.00
Shpenzime komunale	3.600.00	6.000.00	6.000.00	6.000.00
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0
Kapitale	0	60.000.00	0	0
Nr. i stafit	15	26	26	26

Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve të paraqitura si më poshtë janë cak fillestar për shpenzimet e Agjencionit Qendror të Prokurimit Publik. Këta kufij janë përcaktuar duke marrë për bazë koston e politikave ekzistuese dhe vlerësimin fillestar të kapacitetit për financim të iniciativave të reja për riorganizimin e AQP-ës.

Këta kufij të vlerësuar për shpenzimet operative janë një zgjerim mbi vlerësimet e tanishme duke pasqyruar koston operationale për arsye se AQP ka nevojë për rritjen e stafit, Agjencionit Qendror të Prokurimit i nevojitet një staf më i gjerë (minimumi edhe 4 punëtor), për përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësive ndaj Autoriteteve Kontraktuese, dhe kërkesave që dalin nga LPP-ja edhe me amandamentimin e ligjit përgjegjësit dhe obligimet e AQP-ës janë rritur.

Janar 2013

Prishtinë

